



PËRDITËSIMI I VITIT 2026

Përmbaju ose Mbyll

Tetë vjet shkelje ligjore vdekjeprurëse nga termocentralet e qymyrit të Ballkanit Perëndimor



Ky botim është financuar pjesërisht nga Bashkimi Evropian. Megjithatë, pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm të autorit/autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe opinionet e Bashkimit Evropian ose CINEA-s. As Bashkimi Evropian dhe as subjekti që jep grantin nuk mund të mbahen përgjegjës për to.



Sweden
Sverige

Ky publikim është financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim, Sida. Përgjegjësia për përmbajtjen i takon tërësisht autorit. Sida nuk ndan domosdoshmërisht pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.

Hulumtimi dhe shkrimi i raportit:

Ioana Ciuta, Rrjeti Bankwatch për Evropën Qendrore dhe Lindore/ CEE Bankwatch Network

Pippa Gallop, Rrjeti Bankwatch për Evropën Qendrore dhe Lindore/ CEE Bankwatch Network

Davor Pehçevski, Rrjeti Bankwatch për Evropën Qendrore dhe Lindore/ CEE Bankwatch Network

Mirënjohje

Hristina Vojvodić, Platforma për Zhvillim Social dhe Inovacion – CORE

Elena Nikolovska, Qendra për Kërkime dhe Informacion Mjedisor Eko-svest

Redaktimi

Emily Gray, Rrjeti Bankwatch për Evropën Qendrore dhe Lindore /CEE Bankwatch Network

Fotografia e kopertinës

Termocentrali i Nikola Tesla, Serbia

Foto: Stefan Aleksić

Kopertina e prapme

Termocentrali i Kosova A, Kosovë

Foto: Matteo Trevisan, realizuar si pjesë e projektit fotografik me titull "Më i nevojshëm se dielli"

Dizajni

Milan Trivić

Ky raport është mbështetur nga organizatat e mëposhtme:



Përmbajtja

Fjalorth i termave	5
Përmbledhje ekzekutive	6
Hyrje	9
Pasqyra rajonale e emetimeve të ndotësve	10
Rënia e përdorimit të qymyrit	15
Kosovë	18
Konkluzione	22
Rekomandime	23
Shtojca 1: Materialet dhe metodologjia	25

Përmbajju ose Mbyll 2026

Tetë vjet shkelje ligjore vdekjeprurëse nga termocentralet e qymyrit të Ballkanit Perëndimor

www.complyorclose.org

Fjalorth i termave

CBAM – Mekanizmi i Rregullimit të Kufirit të Karbonit. Ky instrument synon të përcaktojë një çmim të drejtë për karbonin e emetuar gjatë prodhimit të produkteve nga sektorë të caktuar të cilat eksportohen në BE, përfshirë këtu edhe energjinë elektrike, dhe të inkurajojë një prodhim industrial më të pastër në vendet jashtë BE. Faza e saj tranzicionale filloi në vitin 2023 dhe nga 1 janari 2026 do të aplikohen tarifat për importin e mallrave në BE.

De-NO_x – Pajisje për zvogëlimin e emetimeve të oksideve të azotit

De-SO_x – Pajisje për zvogëlimin e emetimeve të oksideve të sulfurit

ELV – Vlera Kufitare e Emetimeve. Kjo përfaqëson sasinë e lejuar të një lënde që përmbahet në gazrat e mbetura nga termocentrali i djegies, të cilat mund të shkarkohen në ajër gjatë një periudhe të caktuar; llogaritet masa e vëllimit të gazrave të mbetura, e shprehur në mg/Nm³.

Traktati i Komunitetit Energjetik – i nënshkruar në vitin 2005, i cili hyri në fuqi në vitin 2006 dhe synon të zgjerojë tregun energjetik të BE-së tek fqinjët e saj më të afërt, duke zbatuar legjislacionin e BE-së për energjinë, mjedisin dhe konkurrencën në sektorët e tyre energjetikë. Traktati aktualisht përfshin Bashkimin Evropian, Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Gjeorgjinë, Kosovën, Moldavinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbinë dhe Ukrainën.

BE – Bashkimi Evropian

IED – Direktiva për Emetime Industriale – Direktiva 2010/75/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 24 nëntorit 2010, mbi emetime industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes). Vetëm Kapitulli III, Shtojca V dhe Neni 72(3)-(4) i Direktivës 2010/75/BE janë të zbatueshme në Komunitetin Energjetik.¹ Në BE, është përditësuar nga Direktiva 2024/1785 e 24 prillit 2024, por këto ndryshime ende nuk janë reflektuar në Traktatin e Komunitetit Energjetik.

LCP – termocentral i madh me djegie të brendshme. Ky përkufizohet si një tërësi pajisjesh teknike që përdoren për oksidimin e karburantit me qëllim përdorimin e nxehtësisë së gjeneruar me një hyrje termike nominale të barabartë ose më të madhe se 50 megavat (MW). Kjo përfshin termocentralet të tilla si termocentralet me karburante fosile ose biomasë dhe me djegie të brendshme në rafineritë e naftës.

LCP BREF – Dokumenti referues i teknikave më të mira në dispozicion për termocentralet e mëdha me djegie të brendshme, konkluzat e të cilit u bënë ligjërish të detyrueshme me Vendimin Zbatues të Komisionit (BE) 2017/1442 të datës 31 korrik 2017, që përfshin konkluzat e teknikave më të mira të disponueshme (BAT) dhe – pas një kontesti ligjor mbi baza procedurale – përsëri u rikonfirmuan në Vendimin Zbatues të Komisionit (BE) 2021/2326 të datës 30 nëntor 2021 për përfshirjen e konkluzave për teknikat më të mira të disponueshme (BAT), sipas Direktivës 2010/75/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për termocentralet e mëdha me djegie të brendshme (të njoftuar me dokumentin C (2021) 8580.

LCPD – Direktiva për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme – Direktiva 2001/80/KE mbi kufizimin e emetimeve të disa ndotësve në ajër nga termocentralet e mëdha me djegie të brendshme.

MWe – megavat energji elektrike – forma më e zakonshme e shprehjes së kapacitetit të një termocentrali.

MWth – inputi i vlerësuar termik i përgjithshëm i një termocentrali – vlerësimi i përdorur në legjislacionin e BE për të përcaktuar kategori të ndryshme të madhësive të termocentraleve. Në përgjithësi, është më e vështirë të arrihen përqendrime më të ulëta të emetimeve nga termocentralet më të vogla, kështu që kufijtë e ndotjes kategorizohen sipas madhësisë së tyre.

NERP – Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emetimeve – një mekanizëm fleksibil zbatimi sipas Direktivës për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme në Komunitetin Energjetik, ku emetime mund të zvogëlohen gradualisht duke marrë totalin e emetimeve të tyre së bashku dhe duke siguruar që ato janë më të ulëta se kufijtë maksimalë në ulje, të përcaktuara për vitet 2018, 2023, 2026 dhe 2027.

NO_x – oksidet e azotit

Opt-out – një mekanizëm fleksibil zbatimi sipas Direktivës për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme, ku termocentralet mund të vonojnë investimet në pajisjet e kontrollit të ndotjes për sa kohë që ato kufizojnë funksionimin e tyre në 20 000 orë pune nga 1 janari 2018 deri më 31 dhjetor 2023. Çdo termocentral që operon pas këtyre orëve duhet të jetë në përputhje me rregullat për vlerat e lejuara të emetimeve nga termocentralet e reja, jo ato ekzistuese.

PM ose pluhur – grimca pluhuri

SO₂ – dioksid sulfurik

¹ Për më shumë informata, shih Sekretariatit e Komunitetit Energjetik, [Legjislacioni i Komunitetit Energjetik](#).

Përmbledhje ekzekutive

Fundi i vitit 2025 shënoi tetë vjet nga skadimi afatit që termocentralet në Ballkanin Perëndimor t'i përmbushin standardet e reja të ndotjes së ajrit për dioksidin e sulfurit (SO₂), oksidet e azotit (NO_x) dhe pluhurin. Megjithatë, ndotja vdekjeprurëse e ajrit nga termocentralet kryesisht të vjetruara të qymyrit në rajon është zvogëluar në një nivel shumë jodomethënës për dy substancat e para dhe është rritur për pluhurin.

Në vitin 2025, emetimet totale të SO₂ nga termocentralet e përfshira në Planet Kombëtare të Zvogëlimit të Emetimeve (PKZE)² të Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë ishin **6.6 herë më të larta se sa lejohej – shkelja më e lartë që nga viti 2018**. Në terma absolutë, emetimet kishin rënë pak, por për shkak se kufijtë e emetimeve për secilin vend ishin zvogëluar në vitet 2024 dhe 2025, shkelja e vitit 2025 ishte relativisht më e lartë se në vitet e mëparshme.

Për të dytin vit radhazi, termocentralet e qymyrit të përfshira në PKZE të Bosnjës dhe Hercegovinës ishin emetuesit më të lartë të SO₂ në rajon, me 196,940 ton, ose **12.7 herë më shumë se norma e lejuar**. Kjo ndodhi për shkak të emetimeve vazhdimisht të larta të Bosnjës dhe Hercegovinës, të kombinuara me një rënie të moderuar të emetimeve të SO₂ në Serbi – që më parë ishte emetuesi më i madh. Në vitin 2025, emetimet e SO₂ nga termocentralet me qymyr të Serbisë arritën në 177,756 ton, ose 5.1 herë më shumë se norma e lejuar.

Emetimet absolute të pluhurit u rritën në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024 dhe ishin 2.9 herë më të larta se sa lejoheshin nga PKZE-të e shteteve, krahasuar me 1.9 herë në vitin 2024. Emetimet e pluhurit të Maqedonisë së Veriut u dyfishuan në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024, për shkak të rritjeve masive në termocentralin me qymyr të Manastirit (Bitola).

Ashtu si në vitin 2024, emetimet totale të oksideve të azotit nga termocentralet e përfshira në PKZE në vitin 2025 arritën në 1.4 herë më shumë se sa ishte e lejueshme, për shkak të mungesës së investimeve në zvogëlimin e NO_x dhe kufijve vjetorë në rënie për NO_x në PKZE. Kosova, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia i tejkaloan përsëri kufijtë e vet. Kosova e pati tejkalimin më të lartë - 2.7 herë më të lartë se kufiri i vet kombëtar.

Në terma absolutë, Ugljevik në Bosnjë dhe Hercegovinë, si një nga shkelësit më të hershëm të ndotjes, ishte përsëri njësi me emetimin më të lartë të SO₂ në rajon në vitin 2025, me 115,079 ton ose 16.3 herë më të lartë se kufiri i vet individual. Pavarësisht instalimit të një njësie desulfurizimi, për të cilën u mor një leje operimi në nëntor 2021,³ emetimet e SO₂ të Ugljevikut janë rritur që nga viti 2022. Operatori e pranon se sistemi i de-SO_x nuk po funksionon kryesisht sepse është 'barrë ekonomike' dhe gjithnjë e më shumë po vihet në dyshim nëse ky projekt prej 85 milionë eurosh do të përdoret ndonjëherë siç duhet.

Edhe pse kufijtë individualë të njësive nuk janë obligativ -por vetëm ata në nivel vendi - shqyrtimi i shkeljeve të këtyre kufijve në nivel njësie mund të na ofrojë një tregues të mirë se ku nevojiten ndërhyrje të caktuara. **Në vitin 2025, jo më pak se pesë njësi i tejkaloan kufijtë e tyre për emetimet e dioksidit të sulfurit për më shumë se dhjetë herë: Bitola B 1 & 2 dhe B3 në Maqedoninë e Veriut dhe Ugljevik, Gacko dhe Kakanj 6 në Bosnjë dhe Hercegovinë.**

Për sa i përket pluhurit, emetuesi absolut më i lartë në rajon ishte Bitola B 1 dhe 2 në Maqedoninë e Veriut, e cila emetoi 5,276 ton. Duke përfshirë njësinë B3, me 2,399 ton ndotje nga pluhuri, **termocentrali i Manastirit (Bitola) e tejkaloi i vetëm shumën e kufijve të PKZE për pluhurin e të katër shteteve**, gjithsej 7,094 ton.

Gacko në Bosnjë dhe Hercegovinë ishte përsëri emetuesi më i lartë relativ i pluhurit. Pavarësisht një rënieje të vogël krahasuar me vitin 2024, i emetoi 2,761 ton – 15.1 herë më shumë se sa lejohet.

Për oksidet e azotit, Nikola Tesla B në Serbi përsëri i pati emetimet më të larta absolute në vitin 2025, me 11,247 ton. Në terma relativë, Kosova A5 ishte përsëri shkelësi më i madh për këtë ndotje në vitin 2025, duke emetuar 3.4 herë më shumë se sa lejohet, ose 2,141 ton.

² Si pjesë e detyrimeve të tyre për të respektuar Direktivën për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme sipas Traktatit të Komunitetit Energjetik, katër vende të Ballkanit Perëndimor – Bosnja e Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia – kanë hartuar Planet Kombëtare të Zvogëlimit të Emetimeve (NERP) që mbulojnë periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2027. Në vend që të kërkohet që çdo termocentral i madh me djegie të brendshme të jetë në përputhje me vlerat kufitare të emetimeve nga Direktiva për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme, e miratuar më 1 janar 2018, këto plane u lejojnë vendeve të llogarisin kufijtë kombëtarë të emetimeve të dioksidit sulfurik, oksidit të azotit dhe pluhurit, dhe gradualisht deri në vitin 2027 të zvogëlojnë emetimet e tyre të përgjithshme nga termocentralet e përzgjedhura të mëdha me djegie të brendshme të ndërtuara para vitit 1992. Në vitin 2027 të gjitha termocentralet e përfshira në NERP, individualisht do të duhet të jenë në përputhje jo vetëm me vlerat kufitare të emetimeve nga Direktiva e Termocentraleve të Mëdha me Djegie të Brendshme, por edhe me Pjesën 1 të Aneksit V të Direktivës 2010/75/BE për Emetimet Industriale.

³ Ministria e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimeve dhe Ekologjisë e Republikës Srpska, Vendimi nr. 15.03-360-164/21, 11 nëntor 2021.

Në dhjetor 2023, Këshilli Ministror i Komunitetit Energjetik konfirmoi shkeljet e PKZE-së nga Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Maqedonia e Veriut.⁴ Sekretariati i Komunitetit Energjetik gjithashtu e përshkallëzoi rastin e mosrespektimit kundër Serbisë në vitin 2025 për shkak të mungesës së progresit të mjaftueshëm në uljen e emetimeve të SO₂ dhe shkeljeve të reja të kufirit të NO_x që nga viti 2023.⁵

Shkeljet e PKZE-së përfaqësojnë vetëm një pjesë të ndotjes ilegale nga termocentralet e qymyrit. Në fund të vitit 2023, skadoi afati i fundit për mbylljen e termocentraleve që bien nën përjashtimin e jetëgjatësisë së kufizuar 'regjimi opt-out'. **Të tri vendet në Ballkanin Perëndimor me termocentrale me qymyr që i nënshtrohen kësaj dispozite - Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia - vazhduan ta shkelin atë edhe në vitin 2025.** Asnjë nga termocentralet nuk është mbyllur zyrtarisht ose nuk ka përfunduar rikonstruksionet për të arritur pajtueshmërinë me vlerat kufitare përkatëse të emetimeve, megjithëse Tuzla 3 në Bosnje dhe Hercegovinë raportoi zero orë operimi gjatë vitit. Këto termocentrale jo vetëm që kontribuuan në ndotjen masive nga qymyri në rajon në vitin 2025, por as nuk janë pjesë e shifrave të nxjerra nga PKZE më sipër.

Termocentrali Pljevlja i Malit të Zi ka operuar në mënyrë të jashtëligjshme që nga fundi i vitit 2020, kur i shfrytëzoi 20,000 orët e operimit të lejueshëm pas 1 janarit 2018. Aktualisht është në fazën e testimit pas një rikonstruksioni të diskutueshëm, por mbetet e paqartë nëse kjo do të çojë në pajtueshmëri me vlerat përkatëse të kufinjve të emetimeve. Në vitin 2022, atij iu bashkuan së pari njësitë Tuzla 4 dhe Kakanj 5 të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe më pas termocentrali Morava i Serbisë. Që nga fundi i vitit 2023, kur të gjitha njësitë 'e regjimit opt-out' duhej të mbylleshin, termocentrali Kolubara A në Serbi gjithashtu ka vazhduar të funksionojë. Datat e mbylljes për të gjitha këto njësi mbeten ende të paqarta.

Për shkak të shkeljeve të dispozitave të regjimit 'opt-out', Sekretariati i Komunitetit Energjetik hapi raste për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kundër Malit të Zi në prill 2021⁶, Bosnjës dhe Hercegovinës në tetor 2022,⁷ dhe Serbisë në tetor 2023.⁸ Një vendim kundër Malit të Zi është në pritje në Këshillin Ministror të Komunitetit Energjetik, dhe në mars të vitit 2026 Sekretariati përshkallëzoi çështjet në Moravë dhe Tuzla 4 / Kakanj 5 duke lëshuar opinione të arsyetuara.⁹

Shkelje të tilla janë çështje jete a vdekjeje. Siç tregoi raporti ynë i vitit 2021 "Përmbaju ose Mbyll", nga një total prej 19,000 vdekjesh të shkaktuara nga termocentralet e qymyrit në Ballkanin Perëndimor nga viti 2018 deri në vitin 2020, numri i përgjithshëm i vdekjeve gjatë kësaj periudhe të shkaktuara nga tejkalimet e kufijve të PKZE ishte gati 12,000. Nuk ka asnjë arsye për të pritur që këto shifra të kenë rënë që atëherë.

Këto shkelje janë edhe çështje e sundimit të ligjit: autoritetet kombëtare nuk kanë arritur t'i zbatojnë rregulloret mjedisore në lidhje me ndërmarrjet shtetërore. **Edhe tetë vjet pas kalimit të afatit të pajtueshmërisë me Direktivën e Termocentraleve të Mëdha me Djegie të Brendshme (LCPD) në Komunitetin Energjetik, asnjë operator i vetëm i termocentraleve nuk është gjobitur për këto shkelje.**

Pavarësisht mungesës së vullnetit politik për të siguruar që termocentralet me qymyr t'i përmbahen kushteve ose të mbyllen, problemet teknike në rritje dhe problemet e furnizimit me qymyr kanë çuar në rënien e prodhimit nga termocentralet me qymyr në Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Bosnjë-Hercegovinë në vitet e fundit. Efektet e Mekanizmit për Rregullimin e Kufijve të Karbonit (CBAM) të BE-së nuk janë ende plotësisht të qarta, por duket se do ta ulin prodhimin e energjisë elektrike nga qymyri duke e bërë më të vështirë që kompanitë e shërbimeve t'i balancojnë regjistrat e tyre përmes eksporteve fitimprurëse. Megjithatë, asnjë nga vendet në rajon nuk ka ndonjë plan të qartë, të përditësuar dhe realist për të siguruar përmbushjen e kriterëve dhe/ose mbylljen e të gjitha termocentraleve të tyre me qymyr.

Edhe Maqedonia e Veriut, si lider rajonal për sa i përket instalimit të energjisë diellore, po shpërqendrohet nga minierat e reja të qymyrit dhe planet e kushtueshme për instalimet e gazit, ndërkohë që nuk po bën asgjë për ta adresuar ndotjen nga termocentralet e saj me qymyr. Plani i saj Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (PKEK) i përditësuar, i miratuar së fundmi, nuk specifikon datë të qarta për heqjen graduale të qymyrit, megjithëse skenarët e përmendin vitin 2030.

Në përgjithësi, nivelet e ndotjes edhe tetë vjet pas afatit për zbatimin e LCPD-së mbeten të tmerrshme. Rreziku i një heqjeje graduale të pakontrolluar të qymyrit po rritet me shpejtësi, me ndikime të panevojshme e të theksuara në komunitetet e varura nga qymyri, të cilat mund të ishin shmangur me një planifikim të duhur.

⁴ Këshilli Ministror i Komunitetit Energjetik, [Vendimi 2023/04/MC-EnC mbi mosrespektimin nga Republika e Maqedonisë së Veriut të Traktatit të Komunitetit Energjetik në Rastin ECS-7/21](#), [Vendimi 2023/05/MC-EnC mbi dështimin e Kosovës* për të përmbushur Traktatin e Komunitetit Energjetik në Rastin ECS-8/21](#) dhe [Vendimi 2023/06/MC-EnC mbi mosrespektimin nga Bosnja dhe Hercegovina të Traktatit të Komunitetit Energjetik në Rastin ECS-9/21](#), Komuniteti Energjetik, 14 dhjetor 2023.

⁵ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Rasti ECS 10/21](#), qasur më 24 prill 2026.

⁶ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Rasti ECS-15/21: Mali i Zi / Mjedisi](#), Komuniteti Energjetik, qasur më 19 maj 2025.

⁷ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Sekretariati nis procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve kundër Bosnjës dhe Hercegovinës për shkelje të Direktivës për Termocentrale të Mëdha me Djegie të Brendshme në rastin e Tuzla 4 dhe Kakanj 5](#), Komuniteti Energjetik, 28 tetor 2022.

⁸ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Sekretariati nis procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve kundër Serbisë për shkelje të Direktivës së Termocentraleve të Mëdha me Djegie të Brendshme në rastin e TC Morava](#), Komuniteti Energjetik, 23 tetor 2023.

⁹ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Rasti ECS-01/22: Bosnja dhe Hercegovina / mjedisi](#), [Rasti ECS-09/23: Serbia / mjedisi](#), qasur më 5 maj 2026.

Qeveritë e Ballkanit Perëndimor duhet më në fund ta marrin përgjegjësinë për një heqje graduale e të menaxhuar të qymyrit dhe t'i mbajnë përgjegjëse kompanitë e energjisë për mungesën e veprimeve të tyre. Termocentralet që operojnë nën regjimin "opt-out" duhet të mbyllën menjëherë¹⁰, dhe termocentralet e përfshira në PKZE duhet t'i respektojnë kufijtë e tyre. Urgjentisht, njësitë e desulfurizimit Ugljevik, Kostolac B dhe Nikola Tesla A3-A6 duhet të fillojnë të funksionojnë siç duhet dhe autoritetet në Maqedoninë e Veriut dhe Bosnjë-Hercegovinë duhet të merren me ndotjen masive nga pluhuri nga termocentralet e Manastirit (Bitola) dhe Gackos. Aty ku investimet për kontrollin e ndotjes nuk janë të realizueshme, orët e funksionimit duhet të reduktohen për ta ulur barrën e ndotjes. Kërkesa duhet të reduktohet edhe me masa të tjera, si afatshkurtra ashtu edhe më sistematike, të tilla si zvogëlimi i humbjeve të shpërndarjes, izolimi i ndërtesave dhe përdorimi i pompave efikase të ngrohjes në vend të ngrohësve me rezistencë elektrike. Nevoja për masa të tilla është më e madhe se kurrë.

Përditësimet e ardhshme të strategjive afatgjata dhe PKEK-ve të shteteve ofrojnë një mundësi të mirë për t'i trajtuar dobësitë në planet e tyre aktuale. Ato duhet të përmbajnë plane realiste për një heqje graduale të menaxhuar të qymyrit, bazuar në gjendjen reale teknike të termocentraleve të tyre, nivelin e investimeve të nevojshme që ato të jenë në përputhje me kontrollin e ndotjes, si dhe rezervat e tyre të linjitet dhe kapacitetin e prodhimit.

Edhe pse përgjegjësia kryesore qartazi bie mbi qeveritë e Ballkanit Perëndimor, institucionet e BE-së duhet t'i përshpejtojnë gjithashtu veprimet e tyre, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion, të tilla si kushtëzimi i financimit të BE-së dhe progresit të anëtarësimit me pajtueshmërinë; dërgimi i mesazheve të qarta politike publike; dhe sigurimi i financimit për një tranzicion të drejtë të rajoneve të qymyrit dhe kalimi në ngrohje të qëndrueshme qendrore.

Komisioni Evropian duhet gjithashtu të propozojë mjete më të forta zbatimi për Traktatin e Komunitetit Energjetik, në dobi të shëndetit të njeriut dhe mjedisit. Në mënyrë që Traktati të inkurajojë më tej dekarbonizimin dhe integrimin e tregut, mekanizmi i tij i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve duhet të forcohet për të përfshirë dënime dekurajuese për shkeljet.

¹⁰ Mundësia tjetër është t'i nënshtrohemi një rindërtimi të madh për të përmbushur vlerat kufitare të emetimeve për termocentralet e reja sipas Traktatit të Komunitetit Energjetik, siç po përpiqet të bëjë termocentrali i Pljevljes, por ne jemi skeptikë se kjo do të ishte e realizueshme ekonomikisht.

Termocentrali i Pljevljes, Mali i Zi
NGO Eco-team, Mali i Zi

Hyrje

Që nga afati i zbatimit për Direktivën e Termocentraleve të Mëdha me Djegie të Brendshme (LCPD) në kuadër të Traktatit të Komunitetit Energjetik që skadoi më 31 dhjetor 2017, e kemi analizuar harmonizimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor me Planet e tyre Kombëtare të Zvogëlimit të Emetimeve (PKZE) në shtatë botime të raportit "Përmbaju ose Mbyll". Këtë vit, ne shikojmë mospërputhje të vitit 2025 krahasuar me shtatë vitet e mëparshme.

LCPD u përfshi në Traktatin e Komunitetit Energjetik në vitin 2005, kur edhe u nënshkrua. Për një traktat, qëllimi i të cilit është të hapë dhe unifikojë tregun energjetik të BE me atë të fqinjëve të saj të afërt në Evropën Juglindore dhe Lindore, përfshirja e legjislacionit mjedisor në Traktat është thelbësor për të përgatitur terren të përshtatshëm dhe për të parandaluar rrjedhjet e emetimeve, ku vendet me standarde më të dobëta mjedisore furnizojnë me energji elektrike BE-në.

PKZE u mundëson vendeve të përmbledhin emetimet e dioksidit sulfurik (SO₂), oksideve të azotit (NO_x) dhe pluhurit nga disa ose të gjitha termocentralet e tyre, dhe ato të harmonizohen me një kufi të përgjithshëm të emetimeve, në vend që çdo termocentral të harmonizohet me kufijtë e emetimeve të përcaktuara në anekset e Direktivës. Zhvillimi i një PKZE ishte vetëm një nga opsionet për harmonizim me Direktivën; vendet vendosën vetë nëse do të zhvillonin një të tillë apo jo.¹¹ PKZE lejon që termocentralet me djegie të brendshme të shmangin harmonizimin individual me vlerat kufitare të emetimeve (VKE) për termocentralet ekzistuese, të përcaktuara në Aneksin V, Pjesa 1 e LCPD, deri në vitin 2027. Në vend të kësaj, PKZE vendos vlera kufitare periodike vjetore (2018, 2023, 2026 dhe 2027) që të gjitha emetimet e termocentraleve mbledhur së bashku nuk duhet t'i tejkalojnë, pavarësisht nga emetimet e tyre individuale. Deri në vitin 2027, çdo njësi duhet të përputhet individualisht me VKE-të nga Shtojca V, pjesa 1 e LCPD-së.

Deri atëherë, termocentralet me performancë më të mirë për një ndotës të caktuar mund të kompensojnë ato me performancë më të keqe, nëse plotësohet kufiri i përgjithshëm i përcaktuar. Prandaj, PKZE-ët tashmë përfaqësojnë një kompromis në krahasim me harmonizimin e plotë nga secila njësi: dështimi për t'u harmonizuar me vlerat kufitare të përcaktuara në PKZE është jashtëzakonisht problematik.

Termocentralet ekzistuese me djegie të brendshme kishin gjithashtu një opsion për t'u përjashtuar nga VKE e specifikuar në LCPD ose nga përfshirja në një PKZE, nëse operatori përcaktohej për një funksionim të afatizuar. Kjo mundësoi që termocentralet të funksiononin për jo më shumë se 20 000 orë, duke filluar nga 1 janari 2018 dhe duke përfunduar jo më vonë se 31 dhjetor 2023, pa pasur nevojë të harmonizojë vlerat kufitare të emetimeve. Kushti vlente për njësitë për të cilat ishte planifikuar mbyllja ose rinovimi i plotë. Për të funksionuar përtej këtyre kufijve kohorë, termocentralet duhej të jenë harmonizuar jo vetëm me vlerat kufitare të emetimeve të LCPD, por edhe me ato më të reja dhe pak më të rrepta për termocentralet ekzistuese nga Shtojca V, Pjesa I e Direktivës së Emetimeve Industriale.

Termocentralet me qymyr të cilat janë në përputhshmëri me LCPD ende kanë implikime shëndetësore, por ato që nuk bëjnë këtë, rrisin rrezikshërinë e shëndetit dhe vdekjet e parakohshme në mënyrë të palejueshme dhe të paligjshme. Prandaj, harmonizimi me kufijtë e PKZE dhe kushtet e ndalimit të funksionimit nuk janë vetëm çështje harmonizimi, por çështje jete a vdekjeje. Siç paraqitet në raportin tonë të vitit 2021, midis viteve 2018 dhe 2020, rreth 19 000 njerëz kanë vdekur si rezultat i ndotjes nga termocentralet e qymyrit të Ballkanin Perëndimor, nga të cilat 12 000 ishin për shkak të shkeljeve të vlerave të përcaktuara të emetimeve.¹² Fatkeqësisht, situata ka ndryshuar shumë pak që atëherë. Gjersa emetimet e SO₂ dhe NO_x në tërë rajonin nga termocentralet me qymyr janë ulur deri diku që nga viti 2018, emetimet e pluhurit janë rritur.

Prandaj, është e domosdoshme, madje e vonuar, të ndërmerren veprime për të zvogëluar ndotjen. Ky raport i tetë "Përmbaju ose Mbyll" merr parasysh të dhënat zyrtare të raportuara për vitin 2025, për të parë se si ka evoluar situata që nga viti 2018. Ai ofron një pasqyrë rajonale të rezultateve, së bashku me profilet e vendeve për Bosnjë e Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë.

¹¹ Përveç Malit të Zi, i cili ka vetëm një termocentral të madh me djegie të brendshme dhe për këtë arsye nuk mund ta kalkulojë totalin e disa termocentraleve për të krijuar një kufi kombëtar.

¹² Rrjeti CEE Bankwatch dhe Qendra Kërkimore për Energji dhe Ajër të Pastër (CREA), *Përmbaju ose Mbyll*, Shtator 2021.

Pasqyra rajonale e emetimeve të ndotësve

Deri më 31 dhjetor 2017, që paraqet afatin e fundit për harmonizim me LCPD në vendet e Komunitetit Energjetik, operatorët e termocentraleve të qymyrit në Ballkanin Perëndimor duhet të kenë investuar në pajisjet e kontrollit të ndotjes në një shkallë të mjaftueshme, në mënyrë që të harmonizojnë vlerat kufitare të emetimeve nga Direktiva, ose të paktën për të respektuar vlerat maksimale kombëtare të përcaktuara në Planet Kombëtare të Zvogëlimit të Emetimeve (PKZE). Pas nënshkrimit të Traktatit, vendet kishin 12 vjet kohë për ta bërë këtë, pasi LCPD ka qenë një pjesë integrale e Traktatit që kur hyri në fuqi në vitin 2006.

Por pavarësisht kësaj, asnjë nga vendet me termocentrale të mëdha me djegie të brendshme¹³ deri në fillim të 2018, madje as edhe deri edhe në fund të vitit 2025, tetë vjet më vonë, nuk siguroi që termocentralet e tyre me qymyr të harmonizohen me vlerat kufitare të emetimeve në nivel njësie siç parasheh Direktiva.

Nga viti 2018 deri në fund të vitit 2025, asnjë nga katër vendet me PKZE – Bosnja dhe Hercegovina (BeH), Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia – nuk i përmbushi kufijtë për dioksidin e sulfurit për të cilët ishin zotuar në PKZE-të e tyre, me përjashtim të Kosovës që arriti t'i përmbushte detyrimet në vitet 2023 dhe 2025. Emetimet e dioksidit të sulfurit janë ulur deri diku që nga viti 2018, por as afër sa që t'i përmbushin PKZE-të.

Prandaj, në mars të vitit 2021, Sekretariati i Komunitetit Energjetik hapi procese kontestimi kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë për mosrespektimin e vlerave kufitare të përcaktuara në PKZE-ët e tyre në vitet 2018 dhe 2019.¹⁴ Në shkurt të vitit 2022, bëri hapin e radhës duke ofruar argumente kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.¹⁵ Një opinion i argumentuar është hapi i dytë i këtij procesi, kur palës i kërkohet të korrigjojë çështjet e konstatuara të mosharmonizimit brenda një afati kohor prej dy muajsh. Varësisht nga përgjigjja e qeverisë përkatëse, Sekretariati mund t'ia paraqesë çështjen Këshillit të Ministrave të Komunitetit Energjetik për të marrë një vendim mbi harmonizimin e palës me Traktatin.

Më 13 korrik 2023, Sekretariati ia dorëzoi Këshillit Ministror një kërkesë të argumentuar për të marrë një vendim që konfirmonte mosrespektimin e Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, gjë që e bëri në dhjetor 2023.¹⁶ Meqenëse shkeljet nuk janë korrigjuar, që nga maji 2026, çështjet mbeten të hapura.¹⁷

Rasti kundër Serbisë nuk u përshkallëzua për njëfarë kohe, për shkak të pasigurive në lidhje me ndikimet e investimeve të vazhdueshme në pajisjet e kontrollit të ndotjes. Por në korrik 2025, teksa vazhduan shkeljet e theksuara në lidhje me dioksidin e sulfurit dhe u bënë edhe shkelje të reja për sa i përket oksideve të azotit për shkak të uljes së kufijve çdo vit, Sekretariati lëshoi një opinion të arsyetuar mbi rastin.¹⁸

Është alarmues fakti që të dhënat e përgjithshme të grumbulluara për vitin 2025 në Agjencinë Evropiane të Mjedisit Jetësor¹⁹ nga Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia tregojnë shkelje të vazhdueshme të emetimeve për të tre ndotësit e matur - SO₂, pluhur dhe NO_x.

Edhe pse emetimet absolute të dioksidit sulfurik u ulën deri diku në vitin 2025, shumica e emetimeve të lejuara nga PKZE-të e vendeve u ul gjithashtu, kështu që shkelja e përgjithshme ishte 6.6 herë më e lartë se sa lejohej - më e larta që nga hyrja në fuqi e LCPD-së në vitin 2018. Fakti që Kosova pothuajse arriti t'i përmbahej kufijve e saj në vitet 2023 dhe 2025 nuk ishte i mjaftueshëm për të kompensuar faktin se vendet e tjera i shkelën kufijtë e tyre shumë herë.

¹³ Shqipëria nuk ka në funksion termocentrale të mëdha me djegie të brendshme. Termocentrali 98 MW me naftë dhe gaz në Vlorë asnjëherë nuk ka operuar me kapacitet komercial për shkak të problemeve teknike.

¹⁴ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, Rasti ECS 07/21, Maqedonia e Veriut/Mjedisit, Rasti ECS 08/21, Kosova*/Mjedisit, Rasti ECS 09/21, Bosnja dhe Hercegovina/Mjedisit, Rasti ECS 10/21, Serbia/Mjedisit, qasur më 7 maj 2026.

¹⁵ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, Sekretariati ngre padi kundër tri Palëve Kontraktuese për moszvogëlimin e ndotjes së ajrit nga termocentralet, 23 shkurt 2022.

¹⁶ Këshilli Ministror i Komunitetit Energjetik, Vendimi 2023/06/MC-EnC mbi mosrespektimin nga Bosnja dhe Hercegovina të Traktatit të Komunitetit Energjetik në Rastin ECS-9/21, Vendimi 2023/05/MC-EnC mbi dështimin e Kosovës* për të përmbushur Traktatin e Komunitetit Energjetik në Rastin ECS-8/21, Vendimi 2023/04/MC-EnC mbi mosrespektimin nga Republika e Maqedonisë së Veriut të Traktatit të Komunitetit Energjetik në Rastin ECS-7/21.

¹⁷ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, Rasti ECS 09/21, Bosnja dhe Hercegovina/Mjedisit.


¹⁸ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, Rasti ECS-10/21: Serbia /mjedisit, Komuniteti i Energjisë.

¹⁹ Shih Baza Qendrore e të Dhënave EIONET nën vegzën e vendit > Detyrimet e Bashkimit Evropian > Raportimi mbi termocentralet me djegie të brendshme

Figura 1:

Emetimet e dioksidit sulfurik nga termocentralet me qymyr të Ballkanit Perëndimor, të përfshira në PKZE, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018 deri në 2025

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Emetime dioksid sulfurik	606,467	621,553	660,700	531,466	577,684	589,644	518,248	469,438
Vlera kufitare dioksid sulfurik	103,682	103,682	103,682	103,518 ²⁰	103,518	103,518	87,126	70,732




Emetimet e pluhurit u rritën në vitin 2025 dhe arritën 2.9 herë më të larta se kufijtë e PKZE të vendeve, krahasuar me 1.9 herë më të larta në vitin 2024. Kjo ndodhi pjesërisht për shkak të rritjes absolute të emetimeve dhe pjesërisht për shkak të uljes së kufirit. Termocentrali i Manastirit (Bitola) në Maqedoninë e Veriut, me dy oxhaqet e tij, emetoi 7,675 ton dhe i vetëm shkeli kufirin e rajonit prej 7,094 tonësh për emetimet e pluhurit për vitin 2025.

²⁰ Kufiri i SO₂ i Kosovës ra pak në vitin 2021.

Figura 2:

Emetimet e pluhurit nga termocentralet me qymyr të Ballkanit Perëndimor, të përfshira në PKZE, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018 deri në 2025

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Emetime pluhur	17,414	17,557	18,246	19,808	19,859	19,611	17,348	20,376
Vlera kufitare pluhur	11,200	11,200	11,200	11,180 ²¹	11,180	11,180	9,147	7,094




Në vitin 2022, për herë të parë, emetimet totale të oksideve të azotit tejkaluan pak shumën totale të vlerave kufitare të vendeve - një shkelje që u rrit në gati 1.4 herë kufijtë e kombinuar në vitet 2024 dhe 2025. Kjo ndodhi për shkak se nuk kishte investime në zvogëlimin e NO_x, niveli i kufijve vjetor për këtë ndotës nga viti në vit bëhej më strikt dhe emetimet absolute mbetën në nivele të larta. Kosova dhe Bosnja e Hercegovina ishin shkelësit kryesorë në terma relativë, megjithatë edhe Serbia gjithashtu tejkaloi kufirin e saj të NO_x në vitet 2023, 2024 dhe 2025.

²¹ Kufiri i pluhurit në Kosovë ra pak në vitin 2021.

Figura 3:

Emetimet e oksideve të azotit nga termocentralet me qymyr të Ballkanit Perëndimor, të përfshira në PKZE, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018 deri në 2025

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Emetime oksidet e azotit	77,068	72,136	79,694	67,213	70,767	69,153	62,531	61,179
Vlera kufitare oksidet e azotit	107,353	97,226	87,100	76,768	66,641	48,344	46,378	44,612



Nga kjo më lartë supozohet se të dhënat e emetimeve janë të sakta. Megjithatë, shumë nga të dhënat e ofruara nga operatorët e termocentralit janë më shumë vlerësime sesa rezultat i monitorimit të vazhdueshëm. LCPD²² i detyron vendet të instalojnë dhe operojnë pajisje të vazhdueshme për monitorim të emetimeve, por deri më sot pothuajse gjysma e termocentraleve me qymyr në Ballkanin Perëndimor ose nuk kanë pajisje të tilla të instaluar, ose pajisjet ekzistuese nuk funksionojnë. Prandaj, të dhënat e emetimeve për të gjitha vendet bazohen të paktën pjesërisht në vlerësimet e nxjerra nga matjet një herë në muaj dhe ndonjëherë edhe matjet e kryera një herë në tre muaj.

Në vitin 2025, ashtu si në vitin 2024, termocentralet e qymyrit të PKZE të Bosnjës dhe Hercegovinës ishin emetuesit më të lartë të SO₂ në rajon me 196,940 ton, ose 12.7 herë më shumë se sa lejohet. Edhe pse kjo përfaqësonte një rënie të lehtë të emetimeve absolute krahasuar me vitin 2024 (212,840), në përgjithësi nuk ka pasur përparim të theksuar që nga viti 2018, kur emetimet e SO₂ arritën në 202,005 tonë.

Pas saj ishte Serbia me 177,756 tonë, ose 5.1 herë më shumë se sa lejohet. Kjo përfaqësonte vetëm një rënie modeste krahasuar me vitin 2024, kur emetimet e SO₂ të Serbisë arritën në 205,925 tonë. Emetimet e SO₂ të Serbisë janë ulur ndjeshëm që nga viti 2018, por as afër për aq shpejt sa ishte e nevojshme për të arritur pajtueshmërinë.

²² Neni 12 i Direktives për Termocentralet e Mëdha me Djeqie të Brendshme

Në terma absolutë, shkelësi i vjetër Ugljevik në Bosnjë e Hercegovinë ishte përsëri njësia me emetimin më të lartë të SO₂ në rajon në vitin 2025, me 115,079 tonë. Pavarësisht instalimit të një njësie desulfurizimi, emetimet e saj të SO₂ janë rritur çdo vit që nga viti 2022. Pajisjet e desulfurizimit nuk kanë funksionuar rregullisht midis viteve 2022 dhe 2025, pavarësisht se testimet thuhet se kanë përfunduar me sukses në gusht 2020²³ dhe një leje operimi është marrë për de-SO_x në nëntor 2021.²⁴ Gjithnjë e më shumë po vihet në dyshim nëse ky projekt prej 85 milionë eurosh do të arrijë që termocentrali në Ugljevik të jetë në përputhje me kufijtë e SO₂ dhe me vlerat kufitare të Direktivës për Emetimet Industriale që duhet t'i arrijë deri në vitin 2027.

Nikola Tesla B në Serbi gjithashtu pati emetime absolute jashtëzakonisht të larta të SO₂ në vitin 2025 - 77,470 tonë, të ngjashme me vitin e kaluar. Një njësi desulfurizimi u raportua se kishte filluar funksionimin provues në prill 2026²⁵ (shih kapitullin për Serbinë), por përvoja me Ugljevik dhe Kostolac B (shih më poshtë në këtë kapitull) tregon se nuk ka garanci se do të ketë përmbushje të kriteve.

Edhe pse kufijtë individualë në nivel njësie nuk obligativ – por vetëm ata në nivel vendi - shqyrtimi i shkeljeve të këtyre kufijve në nivel njësie mund të japë një tregues të mirë se ku nevojitet veprim i caktuar.

Në vitin 2025, jo më pak se pesë njësi i tejkaluan kufijtë e tyre për emetimet e dioksidit të sulfurit për më shumë se dhjetë herë:

- Bitola B3, Maqedonia e Veriut: 16.4 herë
- Ugljevik, Bosnjë dhe Hercegovinë: 16.3 herë
- Gacko, Bosnjë dhe Hercegovinë: 12.8 herë
- Kakanj 6, Bosnjë dhe Hercegovinë: 12.5 herë
- Bitola B 1 dhe 2, Maqedonia e Veriut: 11.8 herë

Tuzla 6 dhe Kakanj 7 në Bosnjë dhe Hercegovinë gjithashtu iu afruan këtij niveli, duke emetuar 9.5 dhe 9.8 herë më shumë dioksid sqfuri sesa lejohet nga PKZE i vendit.

Kostolac B, një nga emetuesit më të lartë absolutë dhe relativë të dioksidit të sulfurit nga viti 2018 deri në vitin 2020, më në fund kishte filluar t'i ulte emetimet në vitin 2024, por në vitin 2025 i emetoi 17,452 tonë, ose 3.3 herë më shumë se sa lejohej - pak më shumë se 15,218 tonë që emetoi në vitin 2024. Pavarësisht se kishte instaluar një njësi desulfurizimi, pas një rënieje në vitin 2021, emetimet e tij të SO₂ u rritën në vitet 2022 dhe 2023. Termocentrali me de-SO_x të instaluar nga Korporata e Inxhinierisë së Makinerisë Kineze (CMEC), u inaugurua zyrtarisht në vitin 2017, por mori leje operimi tek në janar të vitit 2023.²⁶

Për sa i përket pluhurit, emetuesi absolut më i lartë në rajon ishte Gacko në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ai emetoi 2,761 tonë, ose 15.1 herë më shumë se sa lejohet në PKZE të BiH-së. Sado tronditëse që është kjo, përfaqëson një rënie krahasuar me emetimet e pluhurit gjatë periudhës nga viti 2022 deri në vitin 2024, kur termocentrali emetoi më shumë se 3,000 tonë në vit.

Termocentrali i Manastirit (Bitola) në Maqedoninë e Veriut shquhet gjithashtu si ndotës i madh i pluhurit. Njësitë e tij B 1 dhe 2 emetuan 5,276 tonë në vitin 2025 - ose 10.7 herë më shumë se sa lejohet - dhe njësia e tij B3 emetoi 2,399 tonë, ose 11.2 herë më shumë se sa lejohet, duke rezultuar në ndikime serioze kumulative.

Emetues të tjerë shumë të lartë të pluhurit në rajon janë njësia Kosova B1, e cila emetoi 2,575 tonë në vitin 2025, ose 6.2 herë më shumë se sa lejohet, dhe Kosova B2, e cila emetoi 1,567 tonë, ose 3.8 herë më shumë se sa lejohet.

Për oksidet e azotit, termocentrali Nikola Tesla B në Serbi pati deri tani emetimet më të larta absolute në vitin 2025, me 11,247 tonë, vetëm pak më të ulëta se emetimet e vitit 2024 prej 12,418 tonësh.

Në terma relativë, Kosova A5 ishte shkelësi më i keq i standardit për oksidet e azotit në vitin 2025, duke emetuar 3.5 herë më shumë se sa lejohet, ose 2,141 tonë.

Të tri vendet me termocentrale që hynë në regjimin e afatizuar për ndalim funksionimi janë ende në shkelje të LCPD-së.

²³ RITE Ugljevik, [Izuzetni rezultati u zaštiti životne sredine](#), 27 gusht 2020.

²⁴ Ministria e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimeve dhe Ekologjisë e Republikës Srpska, [Vendimi nr. 15.03-360-164/21](#).

²⁵ Vladimir Spasić, [EPS e Serbisë fillon funksionimin provues të sistemit të desulfurizimit në termocentralin e qymyrit TENT B](#), Lajme për Energjinë e Gjelbër në Ballkan, 7 prill 2026.

²⁶ Instituti Rregullator i Energjisë së Ripërtëritshme dhe Mjedisit (RERI), [Desulfurizimi në Ballkanin Perëndimor](#), Mars 2023.

Tetë njësi në Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi hynë në të ashtuquajturin regjim 'opt-out' në 2018-ën: Tuzla 3 dhe 4, Kakanj 5, Pljevlja, Morava, Kolubara A3 (Ngrohtorja 1), Kolubara A3 (Ngrohtorja 3, 4 dhe 5) dhe Kolub.²⁷ Por asnjëri prej tyre nuk i ka përmbyllur VKE-të përkatëse, pavarësisht se afati i 31 dhjetorit 2023 ka kaluar shumë kohë më parë dhe shumica e tyre i kanë tejkaluar kufijnjtë e tyre prej 20,000 orësh. Në vitet 2024 dhe 2025, vetëm Tuzla 3 nuk kishte orë të raportuara operimi, por as ajo nuk është mbyllur zyrtarisht (shih kapitullin për Bosnjën dhe Hercegovinën).

Termocentrali i Pljevljes në Mal të Zi po i nënshtrohet një rikonstruktimi, dhe operimi i Tuzla 4 dhe Kakanj 5 në Bosnjë dhe Hercegovinë u zgjat në mënyrë të paligjshme me një vendim të Parlamentit të Federatës së BiH në mars 2022.²⁸ Në fillim të vitit 2023, Elektroprivreda Srbije (EPS) njoftoi se do t'i mbyllte termocentralet Kolubara dhe Morava në fund të vitit 2024,²⁹ por kjo nuk ndodhi dhe strategjia e energjisë e vendit tani e përmend vitin 2030 si cak (shih kapitullin për Serbinë).

Për shkak të shkeljeve të dispozitave të regjimit të përjashtimit nga funksionimi, Sekretariati i Komunitetit Energjetik ngriti raste për konteste kundër Malit të Zi në prill 2021,³⁰ Bosnjës dhe Hercegovinës në tetor 2022³¹, dhe Serbisë në tetor 2023.³²

Në përgjithësi, tetë vjet pas përfundimit të afatit të harmonizimit me LCPD në Komunitetin Energjetik, situata mbetet brengosëse. Që nga viti 2018, emetimet e mbuluara nga PKZE-të janë ulur deri diku për dioksidin e sulfurit dhe oksidet e azotit, ndërsa për pluhurin ato janë rritur. Asnjë nga termocentralet e planifikuara për heqje nga operimi nuk është mbyllur përgjithmonë, me përjashtim të mundshëm të Tuzlës 3. Megjithatë, deri më tani, e vetmja gjobë e vendosur ndaj një operatori të termocentralit për këto shkelje flagrante erdhi nga një gjykatë si rezultat i një padie të shoqërisë civile në Serbi, dhe madje edhe kjo është kundërshtuar nga operatori. Asnjë nga autoritetet përgjegjëse nuk ka lëshuar ndonjë gjobë.

²⁷ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Raporti Përmbledhës i Sekretariatit të Komunitetit Energjetik mbi listën përfundimtare të termocentraleve të përjashtuara](#), Prill 2018.

²⁸ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Shqetësimet mjedisore rriten me vendimin për zgjatjen e funksionimit të Tuzla 4 dhe Kakanj 5](#), 25 mars 2022.

²⁹ Vladimir Spasić, EPS, [përcakton planin për mbylljen e termocentraleve me qymyr](#), Lajme për Energjinë e Gjelbër në Ballkan, 16 shkurt 2023.

³⁰ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Rasti ECS-15/21: Mali i Zi / Mjedisi](#).

³¹ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Sekretariati nis procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve kundër Bosnjës dhe Hercegovinës për shkelje të Direktivës për Termocentrale të Mëdha me Djegie të Brendshme në rastin e Tuzla 4 dhe Kakanj 5](#).

³² Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Sekretariati nis procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve kundër Serbisë për shkelje të Direktivës së Termocentraleve të Mëdha me Djegie të Brendshme në rastin e TC Morava](#).

³³ Ermin Zatega, [Kako je Bosna i Hercegovinës postala ovisna o uvoznjoj električnoj energiji?](#), Radio Slobodna Evropa, 1 maj 2025.




³⁴ Shifrat për vitin 2025 nuk janë ende në dispozicion për Serbinë.

Rënia e përdorimit të qymyrit

Qeveritë dhe shërbimet publike për vite me radhë e kanë paraqitur qymyrin si një burim të besueshëm energjie vendore në Ballkanin Perëndimor, por kjo pikëpamje tani është e vjetëruar dhe në kundërshtim me realitetin. Që nga viti 2026, moshja mesatare e njësive të energjisë me qymyr të rajonit është 49 vjet. Ndërprerjet e planifikuara dhe të paplanifikuara në termocentralet e qymyrit janë gjithnjë e më të zakonshme.

Viteve të fundit, furnizimi me qymyr ka qenë një problem i madh për Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, duke i detyruar ato të drejtohen drejt importeve të kushtueshme. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, furnizimi me qymyr ka qenë gjithashtu problem në të dy entitetet.³³ Në të tri rastet, kjo ka çuar në një rënie të prodhimit të energjisë me bazë qymyri – në Maqedoninë e Veriut që nga viti 2011; në Bosnjë dhe Hercegovinë që nga viti 2018; dhe në Serbi që nga viti 2015, me një rënie në rritje që nga viti 2020.³⁴

Figura 4: Rënia e prodhimit të energjisë nga qymyri në Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi³⁵



³⁵ Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë, Shfletuesi i të Dhënave të Statistikave të Energjisë, qasur më 5 maj 2026; Državna Regulatorna Komisija za Električnu Energiju, Izveštaj o radu Državne Regulatorne Komisije za Električnu Energiju u 2025. godini, Dhjetor 2025; Komisioni Rregullator i Shërbimeve të Energjisë, Ujit dhe Menaxhimit të Mbeturinave Komunale i Republikës së Maqedonisë së Veriut (ERC), Raporti Vjetor 2025, Maj 2026.

Trendet në Kosovë dhe Mal të Zi nuk janë ende aq të qarta, megjithëse prodhimi i energjisë elektrike nga qymyri në Kosovë mund të ketë arritur kulmin në vitin 2021 nëse vazhdojnë trendet aktuale.³⁶

E gjithë kjo ndodhë pa qenë ende i dukshëm ndikimi i plotë i Mekanizmit për Rregullim të Kufijve të Karbonit (CBAM) të BE-së. Regjimi përfundimtar i CBAM filloi në janar 2026, që do të thotë se importet e energjisë elektrike në BE nga Ballkani Perëndimor tani i nënshtrohen tarifave të përcaktuara kryesisht sipas faktorëve të paracaktuar të emetimeve për vend.³⁷ Edhe pse Rregullorja që rregullon CBAM-in lejon përjashtime në sektorin e energjisë elektrike, në varësi të lidhjes së tregut të energjisë elektrike me BE-në, futjes së çmimit të karbonit në nivelin e Sistemit Tregtar të Emetimeve të BE-së dhe disa kushteve të tjera, asnjë nga vendet e Ballkanit Perëndimor nuk është as afër përmbushjes së këtyre kushteve.³⁸

Raporti i parë tremujor i Sekretariatit të Komunitetit Energjetik mbi ndikimet e CBAM-it i identifikoi dy trende kryesore në tremujorin e parë të vitit 2026. Shkëmbimet ndërkuftare të planifikuara në aspektin komercial ranë për 25% përtej kufijve me Shtetet Anëtare të BE-së, pavarësisht gjenerimit të konsiderueshëm nga hidrocentralet për shkak të kushteve të favorshme. Dhe çmimet e energjisë elektrike një ditë më parë në vendet e mbuluara nga Traktati ishin mesatarisht 30 euro/MWh më të ulëta se në tregjet fqinje të BE-së.³⁹ Gjersa Sekretariati theksoi implikimet negative të shtrembërimeve të tilla të mundshme në zhvillim për integrimin e tregut të energjisë elektrike, grupet e shoqërisë civile kanë vënë në dukje anën pozitive të CBAM-it: së fundmi, një përzierje energjie me përmbajtje të lartë karboni - e cila në rastin e Ballkanit Perëndimor nuk përputhet as me standardet kombëtare dhe as me ato të BE-së - ka pasojë për vendet që duan të marrin pjesë në tregjet e energjisë të BE-së.⁴⁰

Në parim, kjo mund t'i inkurajojë qeveritë e Ballkanit Perëndimor që të planifikojnë më mirë një tranzicion të drejtë drejt një ekonomie 100% me energji të ripërtëritshme dhe efikase, megjithëse koha po mbaron për termocentralet e vjetra me qymyr të rajonit. Instalimet e energjisë së erës dhe diellit janë përshpejtuar shumë në tërë rajonin⁴¹ por ende jo mjaftueshëm për t'u përballur me mbylljet e mëdha të termocentraleve të qymyrit.

Qeveritë e rajonit nuk e përdorën raundin e parë të procesit të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) mjaftueshëm mirë për të sjellë siguri në planifikimin e tyre afatmesëm të energjisë, por në vitin 2026 shumë prej tyre duhet t'i përditësojnë strategjitë e tyre afatgjata për klimën⁴² – shans që ata nuk mund ta humbasin. PKEK-të e tyre pritet të përditësohen gjithashtu në vitin 2027, me afatin e fundit për dorëzimin e drafteve në Sekretariatit të Komunitetit Energjetik të caktuar për 1 janar 2028.⁴³ Këtë herë, strategjitë afatgjata duhet të pasqyrojnë një rrugë bindëse të dekarbonizimit për ta arritur neutralitetin klimatik deri në vitin 2050, dhe PKEK-të duhet ta përkthejnë këtë në një plan veprimi të shpejtë, por realist.

Fatkeqësisht, qeveritë e rajonit nuk duket se e kanë marrë mesazhin. Nga njëra anë, ato po përpiqen të shtrydhin çdo pikë të fundit nga termocentralet e tyre me qymyr përmes rikonstruksioneve të kushtueshme, si ai prej 137 milionë eurosh i njoftuar për Kosova A3 në janar 2025 ose ai prej 80 milionë eurosh që është duke u zhvilluar në Pljevlja të Malit të Zi. Kjo nuk ka më kuptim duke pasur parasysh moshën e termocentraleve dhe pashmangshmërinë e futjes së tarifave të karbonit në vitet e ardhshme.

Dhe nga ana tjetër, qeveritë e Ballkanit Perëndimor – me lobim nga Shtetet e Bashkuara – po kërkojnë gjithnjë e më shumë gaz.⁴⁴ Gazifikimi do të ishte një gabim i madh dhe shumë i kushtueshëm për një rajon që është shumë më pak i varur nga gazi fosil sesa BE-ja, dhe kërcënon të shkëpusë vëmendjen nga teknologjitë më të rëndësishme dhe të qëndrueshme ndaj së ardhmes, siç janë energjia diellore dhe e erës, pompat e nxehtësisë dhe energjia gjeotermale.⁴⁵

Siç thotë shprehja, "nëse dështoni të planifikoni, atëherë planifikoni të dështoni", dhe për fat të keq kjo është ajo që po ndodhë tani në shumicën e vendeve. Është tepër vonë për të filluar investime të reja në mënyrë që t'i përmbahemi LCPD, ndërsa mbyllja e termocentraleve dhe minierave të qymyrit kërkon planifikim të kujdesshëm, duke përfshirë një tranzicion të drejtë të komuniteteve të varura nga qymyri. Në mungesë të këtyre të djave mësipër- kolapsi - bëhet një mundësi reale, siç ndodhi në vitin 2024 kur u njoftua mbyllja e minierës së qymyrit të Zenicës në Bosnjë dhe Hercegovinë⁴⁶ pa asnjë plan paraprak.

³⁶ Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë, [Shfletuesi i të Dhënave të Statistikave të Energjisë](#).

³⁷ Shqipëria është i vetmi vend në rajon që nuk i nënshtrohet tarifave të tilla, pasi faktori i saj i paracaktuar i emetimeve është zero - megjithëse kjo do të ndryshonte nëse ajo fillon të përdorë njësitë e saj me naftë në Vlorë ose nëse përfundon termocentralet e saj të planifikuara me gaz në Roskovec dhe Vlorë.

³⁸ CEE Bankwatch Network etj., [Për integrimin e tregut të energjisë elektrike nevojitet pajtueshmëri mjedisore](#), Mars 2026.

³⁹ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Raporti tremujor i CBAM-it](#), 29 prill 2026.

⁴⁰ CEE Bankwatch Network etj., [Për integrimin e tregut të energjisë elektrike nevojitet pajtueshmëri mjedisore](#).

⁴¹ Për më shumë detaje, shih loana Ciuta dhe Pippa Gallop, [Një stuhë e përsosur: Sektori i energjisë elektrike i Ballkanit Perëndimor në kohën e CBAM-it](#), Tetor 2025.

⁴² Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Strategjitë afatgjata](#), qasur më 5 maj 2026.

⁴³ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Procesi i PKEK-ve](#), qasur më 5 maj 2026.

⁴⁴ Belgrade Open School et al., [Deklaratë e përbashkët e shoqërisë civile: Gjersa kriza e fundit e karburanteve fosile fillon të shkaktojë pasojë të rënda, qeveritë e Ballkanit Perëndimor duhet ta shmangin varësinë e mëtejshme të gazit dhe të kalojnë drejt një të ardhmeje me energji të rinovueshme!](#), 27 prill, 2026.

⁴⁵ Me kapjen e çdo gazi të dëmshëm dhe rinjektimin e ujit

⁴⁶ Tatjana Čalić, [Zenica zatvara rudnik: Koji je sljedeći i šta nas čeka sa snabdijevanjem strujom?](#), Buka, 17 dhjetor 2024.

Harmonizimi me vlerat kufitare të PKZE në vitin 2025

Të pesë njësitë me qymyr të Kosovës (Kosova A3, A4 dhe A5 dhe Kosova B1 dhe B2) janë përfshira në PKZE. Në vitin 2025, flota e qymyrit e Kosovës ishte në shkelje të kufijve kombëtarë për dy nga tre ndotësit, pluhurin dhe oksidet e azotit. Ngjashëm me nivelet e vitit 2023, emetimet e dioksidit të sulfurit ishin pak nën kufirin kombëtar, megjithëse njësitë A4 dhe A5 kishin emetime mbi kufijtë e tyre individualë.


Emetimet e pluhurit kanë qenë gjithmonë problemi më i madh i ndotjes në vend. Në vitin 2025, pavarësisht një rënieje të dukshme krahasuar me vitet e mëparshme, ato vazhduan të ishin në mënyrë të papranueshme të larta.

Ndotja nga pluhuri ishte 3.5 herë mbi kufirin kombëtar të përcaktuar në Shtojcën⁴⁷ 2 të PKZE-së dhe arriti në total 4,762 tonë. Vetëm Kosova B1 emetoi pothuajse dyfishin e nivelit të lejuar të pluhurit në vitin 2025, duke lëshuar gjithsej 2,575 ton në atmosferë, 6.2 herë më shumë sesa lejon niveli individual. Kosova B2, e cila emetoi 1,567 tonë pluhur, vazhdoi të ulte ndotjen në vitin 2025 krahasuar me vitet e kaluara. Megjithatë, ndotja arriti në 3.78 herë më shumë se niveli i lejuar.

⁴⁷ Ky aneks nuk është pjesë e NERP-it publik dhe u është bërë i ditur autorëve të këtij raporti.

Figura 10:

Emetimet e pluhurit nga termocentralet me qymyr të Kosovës, të përfshira në PKZE, krahasuar me kufijtë kombëtarë të emetimeve, 2018 deri në 2025 (Të dhënat e vitit 2019 nuk janë në dispozicion)




Emetimet e SO₂ ishin në përputhje me kufirin kombëtar në vitin 2025 dhe arritën në total 10,092 tonë. Edhe pse ishin në përputhje për herë të parë në vitin 2023, emetimet e SO₂ u rritën përsëri mbi prag në vitin 2024. Këto luhajtje janë të vështira për t'u shpjeguar në mungesë të një instalimi funksional të desulfurizimit në ndonjërin njësie.

Megjithatë, emetimet e raportuara të vendit janë në fakt vlerësime: Kosova A nuk ka pajisje për monitorim të vazhdueshëm dhe pajisjet e monitorimit të Kosova B janë funksionale vetëm në intervale të rregullta testimi, midis të cilave emetimet llogariten matematikisht. Në vitin 2025, stafi i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës thuhet se ka ndjekur trajnim në monitorimin, verifikimin dhe raportimin e emetimeve⁴⁸ por është e paqartë se si kjo është e dobishme në mungesë të pajisjeve të monitorimit të vazhdueshëm të instaluar në termocentrale.

⁴⁸ Ministria e Energjisë e Republikës së Kosovës, [Raporti i progresit për periudhën Janar - Qershor 2025 i programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës për periudhën 2022 - 2025](#), 70, Gusht 2025.

Figura 11:

Emetimet e dioksidit sulfurik nga termocentralet me qymyr të Kosovës, të përfshira në PKZE, krahasuar me kufijtë kombëtarë të emetimeve, 2018 deri në 2025 (Të dhënat e vitit 2019 nuk janë në dispozicion)



Në vitin 2025, emetimet e NO_x në Kosovë qëndruan në nivelin më të ulët deri më tani, 14,681 tonë, gjë që ende përfaqëson një shkelje të konsiderueshme prej 2.7 herë më të lartë se kufiri kombëtar. Vendi dallohet në nivel rajonal për shkeljen më të lartë të kufirit të NO_x. Në nivelin e njësisive individuale, Kosova A5 pati shkeljen më të lartë të kufirit të saj individual, duke emetuar 3.39 herë më shumë se sa lejohet, por emetimet nga njësitë A3, A4 dhe B1 janë gjithashtu më shumë se dyfishi i kufijve të tyre individualë.


Termocentrali i Kosova A, Kosovë

Foto: Matteo Trevisan, realizuar si pjesë e projektit fotografik me titull "Më i nevojshëm se dielli"



Figura 12:

Emetimet e oksideve të azotit nga termocentralet me qymyr të Kosovës, të përfshira në PKZE, krahasuar me kufijtë kombëtarë të emetimeve, 2018 deri në 2025 (Të dhënat e vitit 2019 nuk janë në dispozicion)



Karakteristika kryesore e PKZE-së së Kosovës është mospërputhja midis kufijve maksimalë për tre ndotësit që shfaqen në pjesën kryesore të dokumentit⁴⁹ dhe ato të llogaritura në Shtojcën 2 të PKZE-së. Kjo shtojcë nuk është pjesë e PKZE-së që është në dispozicion të publikut dhe u është bërë e ditur autorëve të këtij raporti.

Kufiri i SO₂ i listuar në pjesën kryesore të PKZE-së ndjek vetëm një rënie lineare deri në vitin 2021, dhe më pas ato rriten pak në vitet 2022 dhe 2023. Kufiri i NO_x gjithashtu rritet pak nga viti 2024 e tutje krahasuar me nivelin e vitit 2023 - e kundërta e asaj që duhet të ndodhë. Prandaj, në këtë raport autorët kanë marrë vlerat e kufirit nga shtojca, sepse ato duken më në përputhje me udhëzimet e politikave të Komunitetit Energjetik për përgatitjen e PKZE-ve⁵⁰, edhe pse kufijtë e sipërm për pluhurin dhe NO_x janë më të lartë se ato në pjesën kryesore të dokumentit.

⁴⁹ Qeveria e Kosovës, Plani Kombëtar i Reduktimit të Emetimeve: Kosova, Komuniteti Energjetik, 2018.

⁵⁰ Vlerat kufitare për vitet 2019 deri në 2022 do të përcaktohen duke siguruar një trend linear midis vlerave të viteve 2018 dhe 2023. Në praktikë, kjo do të thotë që vlerat kufitare nuk do të ndryshojnë midis viteve 2018 dhe 2023, përveç NO_x. Komuniteti Energjetik, Udhëzimet e Politikave 03/2014, Dhjetor 2014.

Kosovo (2025)

	Vlera kufitare SO ₂	Emetimet e SO ₂	Vlera kufitare e pluhurit	Emetimet e pluhurit	Vlera kufitare e NO _x	Emetimet e NO _x
Vlera kufitare kryesore sipas NERP	9,497	10,092	475	4,762	6,129	14,681
Vlera kufitare e Shtojcës 2	10,894		1,362		5,446	

Në dhjetor 2023, një vendim i Këshillit Ministror⁵¹ deklaroi se Kosova është në shkelje të Traktatit të Komunitetit Energjetik, së bashku me Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Maqedoninë e Veriut. Raporti i Zbatimit i Komunitetit Energjetik 2025⁵² thekson se 'vendimi përkatës nga Këshilli Ministror mbetet i patrajtuar. Pavarësisht planeve ekzistuese të rinovimit të termocentraleve, pajtueshmëria në të ardhmen e afërt mbetet jorealiste'.

⁵¹ Këshilli Ministror i Komunitetit Energjetik, Vendimi 2023/05/MC-EnC mbi dështimin e Kosovës* për të përmbushur Traktatin e Komunitetit Energjetik në Rastin ECS-8/21.

⁵² Komuniteti Energjetik, Raporti Vjetor i Zbatimit 2025, 83, 1 nëntor 2025.

Investimet aktuale në kontrollin e ndotjes

Drafti i Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) të Kosovës, që i është dorëzuar Sekretariatit të Komunitetit Energjetik në korrik 2023, përforcon Strategjinë e Energjisë të vendit të publikuar një vit më herët⁵³ dhe pretendon se:

Njësitë e termocentralit 'Kosova B1 dhe B2' do të rinovohen për të ruajtur sigurinë e furnizimit dhe për t'i ulur emetimet. Rinovimi i njësive të Kosova B1 dhe B2 do të kryhet në dy faza, dhe deri në fund të vitit 2025 dhe përkatësisht në vitin 2026, të dy njësitë do të operojnë në një mënyrë më efikase dhe të besueshme, duke përmbushur standardet e detyrueshme të emetimeve të Direktivës për Emetimet Industriale.⁵⁴

Planifikimi buxhetor i Strategjisë Kombëtare të Energjisë parashikon një total prej 178 milionë eurosh që do të shpenzohen për rinovimin e secilës prej dy njësive të TC Kosova B (Kosova B1 dhe Kosova B2) ndërmjet viteve 2023 dhe 2025. Sipas Raportit të Progresit të Ministrisë së Energjisë mbi zbatimin e Strategjisë së Energjisë,⁵⁵ pavarësisht se janë ndarë 88 milionë euro në vitin 2024 për Kosova B1 dhe 88 milionë euro të tjera në vitin 2025 për rehabilitimin e Kosova B2, nuk është vërejtur asnjë progres. Data për përmbushjen e pritit të emetimeve të NO_x dhe pluhurit është shtyrë në tetor 2026 për njësinë B1 dhe në tetor 2027 për B2.

Kanë kaluar më shumë se shtatë vjet që kur PKZE i Kosovës parashikoi që Kosova B1 do t'i nënshtrohej rikonstruksionit deri në vitin 2021⁵⁶ në mënyrë që emetimet e pluhurit dhe NO_x të jenë në përputhje me vlerat kufitare të emetimeve të Direktivës për Emetimet Industriale. Parashikohet që njësia B2 të ndiqte këtë shembull dhe të përmbushte kërkesat deri në vitin 2022, me përdorimin e një granti prej 76.4 milionë eurosh në kuadër të Instrumentit të Para-Anëtarësimit II (IPA II) të Komisionit Evropian, të nënshkruar në nëntor 2019.

Këto punime janë shtyrë vazhdimisht dhe në mënyrë të pajustificuar. Një tjetër propozim – për instalimin e de-SO_x – u përfshi në listën indikative të projekteve sipas Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) që vendi ia dorëzoi Komisionit Evropian si pjesë e Agjendës së Reformës në vitin 2024.⁵⁷ Përshkrimi i projektit parashikon një investim prej 105 milionë eurosh për dy njësitë pa cekur një afat kohor konkret, por duke vënë në dukje se "Dizajni paraprak, dizajni i detajuar, dokumentacioni i tenderit dhe nënshkrimi i kontratës së ndërtimit nuk kanë filluar". Kjo është edhe më shqetësuese, pasi ky veprim u bë pas shtatë vitesh mosrespektimi. Projekti nuk ka gjasa të marrë fonde nga WBIF në kuadër të Programit të Reformës dhe Zhvillimit, pasi nuk lejohet mbështetje për lëndët djegëse fosile dhe nuk do të përputhej me afatin kohor të shpenzimeve. Megjithatë, përfshirja e këtij projekti në listën për financim tregon se planet e desulfurizimit janë në hapat e tyre fillestarë. Çuditërisht, në Agjendën e Reformës dhe Rritjes të miratuar të Kosovës, 2 milionë euro të tjera janë planifikuar vetëm për "Përgatitjen e Projektimit të Mbështetjes së BE-së për Ajër të Pastër Fazën 3 (reduktimi i SO_x)"⁵⁸ në kuadër të financimit IPA. Nuk është e qartë pse kjo masë është renditur, duke pasur parasysh se granti IPA për kryerjen e punimeve u nënshkrua në vitin 2019.

Strategjia e Energjisë e vendit, në mënyrë shqetësuese, përmendi gjithashtu se një nga njësitë e Kosova A "do të rinovohet deri në fund të vitit 2024, ndërsa vendimi për rinovimin ose çmontimin gradual të njësisë së dytë do të merret më së voni në vitin 2024".⁵⁹ Ka disa probleme me këtë, por shqetësimi më i madh është vjetërsia e këtyre njësive - mbi 50 vjet. Afati i vitit 2024 doli të ishte i pamundur për t'u përmbushur, por në fillim të janarit 2025, zyra e Kryeministrit bëri një njoftim të papritur⁶⁰ se po fillonin 'aktivitetin e prokurimit (faza I Parakualifikimi) të projektit kapital Rehabilitimi dhe Modernizimi i Njësisë A3 të Termocentralit Kosova A'. Kostoja e shpallur është 137 milionë euro, tashmë 17 milionë euro më e madhe se sa ishte vlerësuar tre vjet më parë në Strategjinë e Energjisë, duke ngritur shqetësime shtesë në lidhje me barrën në rritje mbi buxhetin publik. Njoftimi përmendi gjithashtu një zgjatje të pritit të kohës së funksionimit të termocentralit prej 20 vitesh, e cila është e vështirë të imagjinohet nga pikëpamja e sigurisë, e lëre më nga aspektet mjedisore dhe ekonomike. Megjithatë, tri konsorciume ndërkombëtare u kualifikuan për punimet e rehabilitimit në nëntor 2025,⁶¹ pa ndonjë afat kohor të qartë apo hapa të mëtejshëm.

Strategjia e Energjisë vlerëson se do të nevojiten edhe 120 milionë euro të tjera për ta rehabilituar dhe rritur kapacitetin e instaluar në një njësi të dytë në Kosova A, përveç 137 milionë eurove në Kosova A3. Prapë, nuk është e qartë nëse Kosova mund ta sigurojë këtë financim.

⁵³ Qeveria e Kosovës, [Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031](#), Prill 2022.

⁵⁴ Qeveria e Kosovës, [Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës i Republikës së Kosovës 2025-2030 \(versioni i parë draft\)](#), Komuniteti Energjetik, 82, 2023.

⁵⁵ Republika e Kosovës, Ministria e Energjisë, [Raporti i progresit për periudhën Janar - Qershor 2025 të Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës \(KESIP\) për periudhën 2022 - 2025](#), 19.

⁵⁶ Qeveria e Kosovës, [Plani Kombëtar i Reduktimit të Emetimeve: Kosova](#), 11.

⁵⁷ Komisioni Evropian, DG ENEST, Programi i Reformës dhe Rritjes për Ballkanin Perëndimor, [Agjenda e Reformave të Kosovës](#), versioni i 6 shtatorit 2024.

⁵⁸ Qeveria e Kosovës, [Axhenda e reformave të Kosovës](#), 93, Tetor 2024

⁵⁹ Qeveria e Kosovës, [Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031](#).

⁶⁰ Zyra e Kryeministrit të Kosovës, [Korporata Energjetike e Kosovës investon 137 milionë euro për rehabilitimin dhe modernizimin e Njësisë A3 të Termocentralit Kosova A](#), 24 janar 2025.

⁶¹ Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. [Njoftim mbi zhvillimin e aktivitetit të prokurimit](#), 11 nëntor 2025.

Konkluzione

Nivelet e ndotjes nga termocentralet e qymyrit në Ballkanin Perëndimor tetë vjet pas afatit për zbatimin e LCPD mbeten jashtëzakonisht të larta.

Në vitin 2025, emetimet e të tre ndotësve sërish shkelën vlerat kufitare të përcaktuara në PKZE-ët e Bosnjë e Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë.

Me shtrëngimin e kufirit për të gjithë ndotësit në vitin 2025, shkeljet e vendeve janë edhe më të këqija se në vitet e kaluara. Për herë të parë që kur LCPD hyri në fuqi në vitin 2018, Serbia shkeli PKZE-në e saj për të tri substancat e rregulluara. Por kufijtë më të rreptë nuk e marrin parasysh këtë më vete: termocentralet me qymyr të Maqedonisë së Veriut i kanë dyfishuar emetimet e pluhurit krahasuar me vitin 2024. Emetimet e NO_x u rritën gjithashtu në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut.

Në përgjithësi, në vitin 2025 ndotja me SO_2 nga termocentralet e qymyrit PKZE në tërë rajonin ishte 6.6 herë më e lartë se sa lejohej - shkelja më e lartë relative që nga viti 2018. Bosnja dhe Hercegovina mbeti emetuesi më i lartë në rajon për të dytin vit radhazi. Ndotja nga pluhuri ishte 2.9 herë më e lartë se sa lejohej, krahasuar me 1.9 herë në vitin 2024, e nxitur kryesisht nga një rritje masive në termocentralin e Manastirit (Bitola) në Maqedoninë e Veriut, i cili e tejkaloi i vetëm kufirin rajonal të pluhurit. Ndotja me NO_x ishte gati 1.4 herë më e lartë se sa lejohej, ngjashëm me vitin e kaluar.

Edhe pse Sekretariati i Komunitetit Energjetik ka hapur raste për të gjitha shkeljet, dhe CBAM, problemet teknike dhe prodhimi i ulët i qymyrit në disa vende mund ta përshpejtojnë mbylljen e termocentraleve të qymyrit në rajon, nevojitet më shumë presion mbi qeveritë dhe shërbimet publike dhe një planifikim më i mirë i një heqjeje graduale dhe të menaxhuar të qymyrit nga përdorimi. Pas tetë vitesh shkeljesh, asnjë operator nuk është gjobitur për mosrespektimin e rregullave në rajon.

Tani ekziston një rrezik serioz i një heqjeje graduale e të pakontrolluar të qymyrit, me ndikime të panevojshme e të theksuara në komunitetet e varura nga qymyri, të cilat mund të ishin shmangur me një planifikim të duhur. Asnjë nga PKEK-të e vendeve nuk përcakton qartë se si do të menaxhohet kjo, dhe nevojiten urgjentisht plane të qarta dhe vendimtare. Përditësimet e strategjive të tyre afatgjata të planifikuara për vitin 2026 ofrojnë një mundësi për të sqaruar afatet e tyre të dekarbonizimit dhe për të vendosur një bazë për draftet e ardhshme të PKEK-ve, të cilat duhet të dorëzohen deri më 1 janar 2028.

Politikanët dhe kompanitë e shërbimeve pa dyshim do të përpiqen ta fajësojnë BE-në dhe CBAM-in për pasojat negative sociale që rrjedhin nga rënia e industrisë së qymyrit, por e vërteta është se ata e kanë shkaktuar vetë këtë duke dështuar të planifikojnë dhe të bëjnë investime të përshtatshme. Qeveritë dhe kompanitë e shërbimeve kanë qenë në dijeni të afatit të vitit 2018 të LCPD-së të paktën që nga viti 2005, kur u nënshkrua Traktati i Komunitetit Energjetik, dhe e kanë ditur që CBAM është në ardhje të paktën që nga viti 2019.

Tani është tepër vonë për të filluar projekte të kushtueshme si desulfurizimi, pasi ato nuk do të jenë të realizueshme, kështu që mund të merren vetëm masa me kosto më të ulët. Mundësia për harmonizim po mbyllet, kështu që e vetmja zgjedhje e vërtetë për shumë termocentrale tani është midis mbylljes së kontrolluar, graduale ose kolapsit. Kjo duhet të planifikohet me vëmendje të shtuar ndaj kursimit të energjisë, projektimit të zonave për energji të erës dhe diellit në vendndodhje të përshtatshme, përmirësimeve të rrjetit, pompave gjeotermale dhe të nxehëtisë, duke shmangur shpërqendrimet e kushtueshme si infrastruktura e gazit.

Rekomandime

Qeveritë e Ballkanit Perëndimor duhet më në fund të marrin përgjegjësinë për planifikimin e një eliminimi të menaxhuar të qymyrit dhe të zbatojnë ligjin. Nevoja për ta ulur ndotjen dhe për të rritur efikasitetin e energjisë dhe format e qëndrueshme të energjisë së ripërtëritshme është më e madhe se kurrë, dhe publiku dhe parlamentet duhet t'i mbajnë qeveritë përgjegjëse.

Fabrikat që operojnë sipas regjimit të përjashtimit duhet të mbyllen menjëherë⁶² dhe termocentralet e përfshira në PKZE duhet t'i përmbushin kufijtë e tyre. Më urgjentisht, njësitë e desulfurizimit Ugljevik, Kostolac B dhe Nikola Tesla A3-A6 duhet të fillojnë të funksionojnë siç duhet. Kur investimet për kontrollin e ndotjes nuk janë të realizueshme, orët e funksionimit duhet të reduktohen për të ulur barrën e ndotjes.

Humbja e energjisë duhet të reduktohet edhe me masa të tjera, si afatshkurtra ashtu edhe me sistematike, siç janë zvogëlimi i humbjeve në shpërndarje, izolimi i ndërtesave dhe përdorimi i pompave të nxehtësisë efikase në vend të ngrohësve me rezistencë elektrike. Masave të tilla duhet t'u jepet përparësi shumë më e lartë se sa është aktualisht.

Strategjitë afatgjata të përditësuara të vendeve dhe PKEK-të e përditësuara duhet të përmbajnë plane realiste për një heqje graduale të menaxhuar të qymyrit, bazuar në gjendjen reale teknike të termocentreleve të tyre, nivelin e investimeve të nevojshme që ato të jenë në përputhje me kontrollin e ndotjes, si dhe rezervat e tyre të linjitet dhe kapacitetin e prodhimit. Ndikimet e CBAM-it duhet të integrohen në këto plane, me supozime të qarta dhe transparente bazuar në përvojën e deritanishme.

Edhe pse qeveritë e Ballkanit Perëndimor mbajnë qartë përgjegjësinë kryesore për uljen e ndotjes, institucionet e BE-së duhet të përshpejtojnë gjithashtu veprimet e tyre, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion, të tilla si kushtëzimi i financimit të BE-së dhe progresit të anëtarësimit me pajtueshmërinë; dërgimi i mesazheve të qarta politike publike; dhe sigurimi i financimit për një tranzicion të drejtë të rajoneve të qymyrit dhe kalimi në ngrohje të qëndrueshme qendrore. Komisioni duhet të propozojë mjete më të forta zbatimi për Traktatin e Komunitetit të Energjisë në dobi të shëndetit të njeriut dhe mjedisit. Në mënyrë që Traktati të nxisë më tej dekarbonizimin dhe integrimin e tregut, mekanizmi i tij i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve duhet të forcohet për të përfshirë dënime dekurajuese për shkeljet.

⁶² Mundësia tjetër është t'i nënshtrohem një rindërtimi të madh për të përmbushur vlerat kufitare të emetimeve për termocentralet e reja sipas Traktatit të Komunitetit Energjetik, siç është përpjekur ta bëjë termocentrali i Pljevljes, por jemi skeptikë se kjo është ekonomikisht e realizueshme.

Për qeveritë e Ballkanit Perëndimor

- Të mbyllet termocentralet që janë nën regjimin “opt-out”.
- Të shkurtohen orët e funksionimit për termocentralet që nuk i përmbushin standardet, në mënyrë që të përmbushen kufijtë e emetimeve të PKZE-së, derisa të funksionalizohen pajisjet e kontrollit të ndotjes ose të mbyllet termocentralet.
- Të miratohen ose përditësohen strategjitë dhe PKEK-të afatgjata me plane të qarta dhe transparente për mbylljen graduale të të gjitha termocentraleve të qymyrit dhe datat e përgjithshme të heqjes graduale të karburanteve fosile. Planet duhet të marrin në konsideratë ndikimet e mundshme të tarifave të karbonit dhe/ose Mekanizmit për Rregullim të Kufirit të Karbonit në vitet e ardhshme, dhe duhet të shmangin shpërqendrimet e kushtueshme, siç është gazifikimi.
- Të rriten investimet në masat për energjinë diellore, të erës, të efikasitetit të energjisë dhe përmirësimet në rrjet për të ulur humbjet dhe për të lejuar më shumë lidhje të burimeve të ripërtëritshme, si dhe përdorimin e pompave efikase të ngrohjes për familjet në vend të ngrohësve me rezistencë elektrike, në mënyrë që të minimizohet nevoja për të mbajtur në punë termocentralet e vjetra me qymyr. Të rritet shqyrtimi mjedisor dhe pjesëmarrja e publikut për të minimizuar rezistencën e publikut ndaj investimeve në energjinë diellore, të erës dhe në rrjet.
- Të mundësohen inspektime efektive mjedisore të termocentraleve të mëdha të djegies sipas PKZE-së dhe regjimeve të përjashtimit, me qëllim identifikimin e shkeljeve të rregulloreve kombëtare të mbrojtjes së ajrit dhe zbatimin e masave dhe sanksioneve të duhura aty ku është e aplikueshme.
- Rritja e vëmendjes drejt planifikimit pjesëmarrës nga poshtë-lart për një tranzicion të drejtë në ato termocentrale dhe miniera të qymyrit që do të mbyllet të parat.

Për autoritetet e Kosovës

- Si minimum, të caktohen ndëshkime bindëse ndaj KEK-ut për shkeljet e kufijve të emetimeve të PKZE-së.
- Të reduktohen menjëherë orët e funksionimit të të gjitha njësive për t'i sjellë ato në përputhje me kufijtë e tyre të PKZE-së, veçanërisht në lidhje me emetimet e pluhurit nga Kosova B.
- Të fillojë mbyllja e Kosova A, njësi pas njësie, pasi duket shumë e pamundur që investimet e mëtejshme në kontrollin e ndotjes të jenë ekonomisht të justifikueshme për një termocentral të kësaj moshe. Të rivlerësohet urgjentisht justifikimi ekonomik për investimin e planifikuar prej 137 milionë eurosh në Kosova A3 dhe investimet e tjera të planifikuara në Kosova A.
- Të përshpejtohen punimet e rikonstruksionit për ta sjellë në përputhje me standardet e emetimeve të pluhurit dhe NO_x termocentralin Kosova B. Të publikohen informata të përditësuara mbi statusin e projektit dhe një justifikim për vonesat e shumta dhe të sigurohet përfundimi i shpejtë i projektit për të përmirësuar monitorimin e vazhdueshëm në termocentralin Kosova B.

Për Komunitetin e Energjisë

- Sekretariati duhet të vazhdojë t'i ndihmojë Palët Kontraktuese në përditësimin e strategjive të tyre afatgjata dhe PKEK-ve, duke rritur investimet në format e qëndrueshme të energjisë së ripërtëritshme, duke futur tarifatt e karbonit, duke parandaluar kycjen në projekte të gazit dhe duke u përgatitur për një tranzicion të drejtë.
- Duke pasur parasysh mosrespektimin e vazhdueshëm të kërkesave në lidhje me Moravën dhe termocentralet e tjera të përjashtuara në Serbi, Tuzla 4 dhe Kakanj 5 në Bosnjë dhe Hercegovinë, si dhe termocentralet PKZE të Serbisë, të përshkallëzohen këto raste drejt Këshillit Ministror.
- Ne i bëjmë thirrje Këshillit Ministror që ta konfirmojë shkeljen e dukshme të Traktatit të Komunitetit Energjetik nga Plevlja pa vonesa të mëtejshme.

Për Komisionin Evropian dhe Shtetet Anëtare të BE-së

- Të fillojë forcimi i Traktatit të Komunitetit Energjetik për të siguruar ndëshkime bindëse në rastet e mosrespektimit.
- Të sigurohen fonde shtesë dhe të dedikuara për një tranzicion të drejtë të rajoneve të qymyrit dhe ngrohjes qendrore të qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë fondet në dispozicion të drejtpërdrejtë të autoriteteve lokale.
- Të sigurohet që përjashtimet e mundshme nga CBAM sipas Nenit 2(7) të Rregullores të zbatohen me rigorozitet.
- Të sigurohet që përputhshmëria me LCPD-në të integrohet si kusht në çdo fond të ardhshëm të BE-së për rajonin, veçanërisht ato që veprojnë mbi parimin e Instrumentit për Reformë dhe Rritje.
- Për të adresuar mungesën e përputhshmërisë me Direktivën për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme dhe Direktivën për Emetimet Industriale, theksoni rëndësinë e zbatimit në nivel kombëtar, duke kërkuar një rol më aktiv për inspektoratet dhe zbatim para gjyqësorit kombëtar.
- Të sigurohet që financimi i BE-së dhe ai ndërkombëtar të mos mbështesin gazin në mënyrë që të shmanget krijimi i varësisë së mëtejshme nga lëndët djegëse fosile.

Shtojca 1

Materialet dhe metodologjia

Emetimet e termocentraleve me qymyr të Ballkanit Perëndimor u mblodhën nga [Baza Qendrore e të Dhënave EIONET](#). Të dhënat për vitin 2025 do të verifikohen vetëm nga Agjencia Evropiane e Mjedisit brenda disa muajve të ardhshëm, kështu që ato duhet të konsiderohen paraprake.

Planet Kombëtare të Zvogëlimit të Emetimeve të përdorura janë dokumente zyrtare të publikuara nga secili prej vendeve. Kufijtë e përgjithshëm në nivel vendi të përdorur si referencë përfshijnë, në disa raste (p.sh. Serbia), kufijtë e emetimeve nga objekte të tjera që nuk janë termocentrale me qymyr (p.sh. rafineritë), gjë që shpjegon pse në ato raste kufijtë kombëtarë janë më të lartë se shuma e kufijve të termocentraleve individuale me qymyr. Në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës, PKZE përfshinë Tuzla 4 dhe Kakanj 5, të cilat më vonë u shpallën termocentrale nën regjimin "opt-out", kështu që ato janë përjashtuar nga vlerat kufitare.



CEE Bankwatch
Network

QERSHOR 2026